



## URDHRI I STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISE KËSHILLI KOMBËTAR

Tiranë, më 19.12.2025

### RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN, LIÇENSIMIN DHE ANËTARËSIMIN NË USSH

#### KREU I PARIME TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Objekti, qëllimi dhe baza ligjore

1. Objekt i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla të detajuara për regjistrimin, liçensimin dhe anëtarësimin në USSH të stomatologëve dhe ndihmësstomatologëve, si dhe të gjithë profesionistëve në ndihmë të shërbimit stomatologjik në kuptim të ligjit nr. 9928, datë 9.6.2008 “*Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë*”.
2. Kjo rregullore është hartuar në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 127/2014 “*Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë*”, Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 9928, datë 9.6.2008 “*Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë*”, rregullores “*Për shërbimin e shëndetit oral në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe rregullores “*Për praktikën profesionale për profesionistin e shëndetit në Republikën e Shqipërisë*”.
3. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve, procedurave për regjistrimin, liçensimin dhe anëtarësimin në USSH të stomatologëve dhe ndihmësstomatologëve.

##### Neni 2 Parimet e rregullores

1. Përveç bazës ligjore të përmendur më sipër, Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë, në ushtrimin e funksioneve të tij gjatë procedurës për regjistrimin, liçensimin dhe anëtarësimin në USSH bazohet në parimet si më poshtë:
  - a) E Drejta për një proces të rregullt ligjor, duke përfshirë të drejtat e palëve për të paraqitur prova, për tu dëgjuar, për tu përfaqësuar nga një mbrojtës, si dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm.

- b) Parimin e ligjshmërisë, i cili parashikon se USSH ushtron veprimtarinë e saj në bazë të legjislacionit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për liçensim/riliçensim në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 127/2014 “Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 9928, datë 9.6.2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kësaj rregulloreje brenda kufijve të kompetencave të saj dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.
  - c) Parimin e transparencës, cili parashikon se USSH ushtron veprimtarinë e saj administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.
  - d) Parimin e informimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së konfidencialitetit, të cilët përfshijnë të drejtën e çdo subjekti për të kërkuar informacion publik që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit dhe në të njëjtën kohë detyrimin e organit publik (USSH) për të mbrojtur të dhënat personale dhe konfidenciale të të gjithë subjekteve që marrin pjesë në një gjykim disiplinor.
  - e) Parimi i drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit, i cili parashikon se në ushtrimin e funksioneve të saj USSH trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, USSH merr në konsideratë dhe i jep rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.
2. Gjithashtu, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, USSH respekton parimin e barazisë përpara ligjit, parimin e proporcionalitetit, të drejtën për të bërë ankim, si dhe çdo të drejtë që i garantohet subjekteve të së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe legjislacionit në fuqi.
  3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, USSH zbaton marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjet e lidhura nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, apo ministria përgjegjëse për arsimin, ose shëndetësinë me organet homologe të vendeve të tjera.

### **Neni 3**

#### **Regjistri Themeltar i Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë dhe regjistrat e urdhrave rajonale**

1. Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë krijon dhe administron regjistrin themeltar të urdhrit, i cili është i ndarë në pjesë të veçanta për stomatologët dhe ndihmësstomatologët si dhe të gjithë profesionistëve në ndihmë të shërbimit stomatologjik (Teknikë dentare, teknikë e lartë dentar, higjenist dentar, asistent dentar) dhe menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij. Regjistri mbahet në formë të shkruar dhe elektronike. Sektori i Liçensimit në USSH është struktura përgjegjëse për administrimin e regjistrit dhe përditësimit të tij, duke

respektuar legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të dhënat që mbahen dhe shënohen në regjistrë janë emri, atësia, mbiemri, datëlindja, numri i telefonit, adresa ku ushtrohet profesioni, email, institucioni arsimor ku janë përfunduar studimet, duke përfshirë datën e diplomimit (për rastet kur studimet janë përfunduar jashtë shtetit, dokumenti i lëshuar nga institucioni kompetent për njohjen dhe njësimin e diplomës), numri i licënsës, data e lëshimit, procedime disiplinore nëse ka (lloji i masës disiplinore, që përfshin numrin e vendimit të komisionit rajonal, komisionit kombëtar dhe/ose gjykatës nëse çështja është gjykuar pranë gjykatës).
3. Urdhrat e Stomatologut në Rajone mbajnë regjistrat e tyre për licënsimin dhe rilicënsimin, për të cilat zbatohen të njëjtat parime që zbatohen edhe në rastin e regjistrit themeltar të urdhrit.
4. Presidenti i USSH dhe Aparati Qëndror i Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë janë organet që vendosin për regjistrimin, licënsimin dhe anëtarësimin në USSH të stomatologëve dhe ndihmësstomatologëve, si dhe të gjithë profesionistëve në ndihmë të shërbimit stomatologjik në kuptim të ligjit nr. 9928, datë 9.6.2008 “*Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë*” që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Licënsimi dhe anëtarësimi në USSH finalizohet me lëshimin e licënsës për ushtrimin individual të profesionit për një periudhë të caktuar, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Licënsa është dokumenti zyrtar i lëshuar nga USSH që lejon ushtrimin e profesionit individual të stomatologut. Licënsa lëshohet për çdo çdo anëtar të USSH, i cili ka kryer praktikën profesionale, provimin VAP dhe ka kaluar me sukses provimin e shtetit pranë organit kompetent në Republikën e Shqipërisë.
5. Licënsimi dhe rilicënsimi për subjektet e kësaj rregulloreje bëhet çdo pesë vjet.
6. Drejtues teknik është funksioni që ka përgjegjësinë teknike, profesionale dhe ligjore, përveç përgjegjësisë personale të stomatologut (kur ka shkelje të ligjit, ose Kodit Etik dhe Deontologjik), në emër të subjektit që licënsohet. Licënsa për këtë funksion lëshohet për të gjitha subjektet, të cilat ofrojnë shërbimin stomatologjik. Për kabinetet dentare, klinikat dentare, spitalet dentare, duhet të ketë një drejtues teknik për çdo katër stomatologë.  
Për profesionistët në ndihmë të shërbimit stomatologjik në kuptim të ligjit nr. 9928, datë 9.6.2008 “*Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë*” që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë duhet të ketë një drejtues teknik me eksperiencë pune mbi pesë vjet.
7. Me kërkesë të subjektit të interesuar, drejtuesi teknik licënsohet dhe ri-licënsohet nga USSH çdo pesë vjet sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

## KREU II

### REGJISTRIMI, LICËNSIMI DHE ANËTARËSIMI NË USSH

#### Neni 4

#### **Dokumentacioni i nevojshëm për praktikën profesionale**

1. Dokumentacioni që nevojitet për të zhvilluar praktikën profesionale është:

- a) Kërkesa me shkrim e të diplomuarit për regjistrimin në praktikën profesionale dhe vetëdeklarimi për hyrjen në provimin e shtetit që organizohet nga organi kompetent në Republikën e Shqipërisë/ Formulari i aplikimit.
  - b) Fotokopje e kartës së identitetit. Për shtetasit e huaj që kanë përfunduar studimet në Republikën e Shqipërisë, përveç kopjes së kartës së identitetit/pasaportës së vlefshme në vendin e origjinës, paraqitet kopje e noterizuar së lejes së qëndrimit dhe lejes së punës, të lëshuara nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
  - c) Fotokopje e noterizuar e diplomës, ose vërtetimit të barazvlefshëm me të sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe suplementit të diplomës. Për aplikuesit që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç dokumenteve të përmendura më sipër, duhet të paraqitet edhe vërtetimi i njohjes dhe njësimit të diplomës, i lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Shqipërisë.
  - d) Raporti mjeko ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - e) Dëshminë e penalitetit për një vepër penale të rëndë.
  - f) Deklaratën e lëshuar nga drejtuesit teknik që do të mbikqyrë stazhin e të diplomuarit pranë klinikës së tij e shoqëruar me liçensën dhe ekstraktin e QKB së klinikës. Në rastet kur praktika profesionale zhvillohet pranë një institucioni publik, deklarata/vërtetimi lëshohet nga drejtuesi teknik i institucionit.
  - g) Pagesa për hapjen e dosjes nga USSH.
2. Praktikanti regjistrohet nga Sektori i Liçensimit në një regjistër të veçantë. Pasi është regjistruar praktikanti pajiset me:
    - a) Certifikatën e praktikantit.
    - b) Librezën e praktikës profesionale (stazhit).
  3. Praktikanti në përfundim të praktikës profesionale, dorëzon në USSH certifikatën e praktikantit, si dhe librezën e praktikës profesionale për vlerësimin e tij të plotësuar të firmosur dhe vulosur nga drejtuesi teknik i klinikës.

## **Neni 5**

### **Dokumentacioni i nevojshëm për liçensimin për herë të parë pwr ushtrimin e profesionit e stomatologut**

1. Aplikimi për regjistrimin për herë të parë bëhet online nëpërmjet portalit të USSH. Regjistrimi për herë të parë bëhet gjithmonë nga urdhri rajonal ku stomatologu ka gjendjen civile.
2. Për tu regjistruar dhe anëtarësuar për herë të parë në USSH, stomatologu shtetas shqiptar, duhet të ngarkojë në sistem këto dokumenta:
  - a) Kërkesën për anëtarësim në të cilën stomatologu shpreh vullnetin se njih Statutin e USSH, Kodin Etik dhe Deontologjik të Stomatologut dhe do të respektojë dispozitat e këtyre akteve dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
  - b) Diplomën, ose vërtetimin e diplomimit dhe listën e notave/suplementin e diplomës të noterizuar. Shtetasit shqiptar tw diplomuar jashtw vendit duhet tw upload diplomën

ose vërtetimin e diplomimit dhe listën e notave/suplementin e diplomës të noterizuar dhe të njohur nga organet kompetente.

- c) Raporti mjeko ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - d) Dëshminë e penalitetit të muajit të fundit.
  - e) Foto digjitale.
  - f) Mandat pagesa për liçensimin për herë të parë.
  - g) Dokumentat e parashikuara në nenin 4 pika 3 “a” dhe “b” të firmosura sipas parashikimeve të këtij neni.
  - h) Certifikata personale me anë të së cilës vërtetohet ku është gjendja civile.
3. Sekretaria e USSH rajonale printon dokumentat e uploaduara në sistem dhe krijon dosjen fizike të stomatologut. Një kopje të kësaj dosje e printon dhe Sektori i Liçensimit në USSH dhe e mban në arkivën e institucionit.
4. Për mjekwt stomatologw, shtetas tw huaj tw cilwt kanë përfunduar studimet në Republikën e Shqipërisë, pwrveç dokumentave tw pikws 2, gwrma a,b,c,d,e,f,g duhet tw upload edhe kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit dhe lejes së punës, si dhe dokumentin që provohen se njohin gjuhën shqipe.
- a) Raporti mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - b) Foto digjitale
  - c) Mandat Pagesa në favor të USSH për liçensimin për herë të parë.
5. Mjekët stomatologë shtetas të huaj që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Shqipërisë që do të ushtrjnë profesionin si rezident në Republikën e Shqipërisë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:
- a) Kërkesën për anëtarësim në të cilën stomatologu shpreh vullnetin se njeh Statutin e USSH, Kodin Etik dhe Deontologjik të Stomatologut dhe do të respektojë dispozitat e këtyre akteve dhe legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe curriculum vitae.
  - b) Kopjen e kartës së identitetit/pasaportës së vlefshme në vendin e origjinës, shoqëruar nga kopja e noterizuar së lejes së qëndrimit dhe lejes së punës së lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
  - c) Fotokopje e noterizuar e diplomës, ose vërtetimit të barazvlefshëm me të, suplementit të diplomës dhe vërtetimi i njohjes dhe njësimit të diplomës, i lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Shqipërisë.
  - d) Fotokopje të noterizuar të liçensës së ushtrimit të profesionit të stomatologut të vlefshme në vendin përkatës.
  - e) Certifikatën e sjelljes së mirë (*Good Standing Certificate*), të lëshuar nga organi kompetent në vendin ku stomatologu ushtron profesionin e tij, e cila vërteton se ndaj stomatologut nuk është marrë asnjë masë disiplinore, apo nuk ka masë disiplinore në fuqi e lëshuar jo më shumë se 30 ditë përpara se të bëhet aplikimi.
  - f) Dëshmia e penalitetit, ose kopje e noterizuar në bazë të të cilës vërtetohet se aplikuesi nuk është dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit në vendin përkatës e lëshuar jo më shumë se 30 ditë përpara se të bëhet aplikimi.

- d) Vërtetimin e lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, me anë të të cilit vërtetohet se stomatologu njeh, kupton dhe flet gjuhën shqipe (provimin e gjuhës shqipe).
  - e) Raportin mjeko-ligjor që vërteton se është i aftë për punë.
  - f) Foto digjitale
  - g) Mandat pagesa për liçensimin për herë të parë.
6. Mjekët stomatologë, shtetas të huaj që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Shqipërisë që do të ushtrojnë profesionin si jo rezident në Republikën e Shqipërisë duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:
- a) Kërkesën për anëtarësim në të cilën stomatologu shpreh vullnetin se njeh Statutin e USSH, Kodin Etik dhe Deontologjik të Stomatologut dhe do të respektojë dispozitat e këtyre akteve dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe curriculum vitae.
  - b) Kopjen e kartës së identitetit/pasaportës së vlefshme në vendin e origjinës, shoqëruar nga kopja e noterizuar së lejes së qëndrimit dhe lejes së punës së lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
  - c) Fotokopje e noterizuar e diplomës, ose vërtetimit të barazvlefshëm me të, suplementit të diplomës dhe vërtetimi i njohjes dhe njësimit të diplomës, i lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Shqipërisë.
  - d) Fotokopje të noterizuar të liçensës së ushtrimit të profesionit të stomatologut në vendin përkatës.
  - e) Certifikatën e sjelljes së mirë (*Good Standing Certificate*), të lëshuar nga organi kompetent në vendin ku stomatologu ushtron profesionin e tij, e cila vërteton se ndaj stomatologut nuk është marrë asnjë masë disiplinore, apo nuk ka masë disiplinore në fuqi e lëshuar jo më shumë se 30 ditë përpara se të bëhet aplikimi.
  - f) Dëshmia e penalitetit, ose kopje e noterizuar në bazë të të cilës vërtetohet se aplikuesi nuk është dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit në vendin përkatës e lëshuar jo më shumë se 30 ditë përpara se të bëhet aplikimi.
  - g) Deklaratën noteriale/kontratën e punës për punësimin e një përkthyesi të liçensuar nga Ministria e Drejtësisë që përkthen gjuhën e stomatologut të shoqëruar me vërtetimin për punësimin e përkthyesit në klinikë të lëshuar nga organet tatimore.
  - h) Kontratën e punës me klinikën ku do të jetë i punësuar.
  - i) Deklaratën e Drejtuesit Teknik të klinikës ku do të punësohet stomatologu sipas formës së miratuar nga USSH.
  - j) Raportin mjeko-ligjor që vërteton se është i aftë për punë.
  - k) Foto digjitale
  - l) Mandat pagesa për liçensimin për herë të parë.
7. Për stomatologët që kanë fituar liçensën e tyre në një nga vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje të veçantë për njohjen e kualifikimeve profesionale zbatohet drejtpërdrejtë marrëveshja.

## Neni 6

### Dokumentacioni i nevojshëm për ri-liçensimin për ushtrimin e profesionit të stomatologut

1. Aplikimi për riliçensim bëhet online nëpërmjet portalit të USSH.
2. Për tu ri-liçensuar, stomatologu duhet të ngarkojë këto dokumenta:
  - a) Kërkesën për ri-liçensim kopjen e liçensës, si dhe cv të përditësuar deri në datën kur bëhet kërkesa për riliçensim.
  - b) Kopjen e noterizuar të Diplomës së ciklit të tretë të studimeve specializime afatgjata, që janë ndjekur gjatë periudhës midis liçensimit dhe ri-liçensimit (në rast se ka).
  - c) Dokumentin e lëshuar nga organi kompetent që vërteton plotësimin e krediteve të edukimit në vazhdim të nevojshme për ushtrimin e profesionit dhe ri-liçensimit.
  - i) Raporti mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - j) Dëshminë e penaltetit dhe vërtetim nga Prokuroria.
  - k) Foto digjitale
  - l) Mandat pagesa në favor të USSH të kuotave vjetore deri në afatin e riliçensimit dhe pagesën për riliçensim.
3. Subjektet që kanë fituar liçensën për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi në kohën e liçensimit, por që për arsye të ndryshme kanë ushtruar profesionin e stomatologut jashtë Republikës së Shqipërisë në zbatim të legjislacionit të një vendi tjetër duhet të bëjnë kërkesë në USSH duke paraqitur dokumentet si më poshtë:
  - a) Kërkesën për ri-liçensim, kopjen e liçensës, si dhe cv të përditësuar deri në datën kur bëhet kërkesa për riliçensim.
  - b) Kopjen e noterizuar të Diplomës së ciklit të tretë të studimeve specializime afatgjata, që janë ndjekur gjatë periudhës midis liçensimit dhe ri-liçensimit (në rast se ka).
  - c) Dokumentin e lëshuar nga organi kompetent që vërteton plotësimin e krediteve të nevojshme për ushtrimin e profesionit dhe ri-liçensimin. Numri i krediteve të fituara nuk mund të jetë më pak se numri i krediteve të nevojshme që duhen fituar për të ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë. Në rast se numri i krediteve të fituara është më pak se numri i krediteve që duhen fituar në Republikën e Shqipërisë, riliçensimi nuk mund të bëhet deri kur të plotësohet numri i krediteve të nevojshme, i cili vërtetohet me dokumentin përkatës.
  - d) Fotokopje të noterizuar të liçensës së ushtrimit të profesionit të stomatologut jashtë Republikës së Shqipërisë.
  - e) Certifikatën e sjelljes së mirë (*Good Standing Certificate*), të lëshuar nga organi kompetent në vendin ku stomatologu ushtron profesionin e tij, e cila vërteton se ndaj stomatologut nuk është marrë asnjë masë disiplinore, apo nuk ka masë disiplinore në fuqi, të lëshuar jo më shumë se 30 ditë përpara aplikimit.
  - f) Raporti mjeko ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - g) Dëshminë e penaltetit apo çdo dokument tjetër të lëshuar nga organi kompetent i vendit ku ka punuar stomatologu që vërteton që stomatologu nuk është i dënuar, apo është në ndjekje penale për vepra penale që lidhen me profesionin e stomatologut.

- h) Foto digjitale
- i) Mandat pagesa tw kuotave vjetore deri nw afatin e rilicensimit dhe pageswn për rilicensim.
- 4. Sekretaritetë rajonale i shtojnë këto dokumenta në dosjen e hapur për liçensimin për herë të parë nga aplikuesi. Në çdo rast sekretaritetë marrin masat që aplikuesi të mos paraqesë dokumenta, të cilat janë paraqitur më parë.
- 5. Mjekët stomatologë, shtetas të huaj që ushtrojnë profesionin si rezident që duan të rilicensohen aplikojnë on line në sistemin e USSH duke ngarkuar dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kërkesën për ri-liçensim si dhe cv të përditësuar deri në datën kur bëhet kërkesa për rilicensim.
  - b) Kopjen e noterizuar të diplomave të ciklit të tretë, specializimeve (nëse ka) që janë ndjekur gjatë peridhës midis liçensimit dhe ri-liçensimit.
  - c) Dokumentin e lëshuar nga organi kompetent që vërteton plotësimin e krediteve të nevojshme për ushtrimin e profesionit dhe ri-liçensimin. Numri i krediteve të fituara nuk mund të jetë më pak se numri i krediteve të nevojshme që duhen fituar për të ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë. Në rast se numri i krediteve të fituara është më pak se numri i krediteve që duhen fituar në Republikën e Shqipërisë, rilicensimi nuk mund të bëhet deri kur të plotësohet numri i krediteve të nevojshme, i cili vërtetohet me dokumentin përkatës.
  - d) Kopje e noterizuar së lejes së qëndrimit dhe lejes së punës së lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
  - e) Dëshmia e penalitetit, ose çdo dokument në bazë të të cilit vërtetohet se stomatologu nuk është dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit në vendin përkatës.
  - f) Raporti mjeko ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - g) Foto digjitale në formatin 3x4
  - h) Pagesa për kuotazicionet vjetore dhe pagesa në favor të USSH për ri-liçensim.

## **Neni 7**

### **Dokumentacioni i nevojshëm për liçensimin për herë të parë për ndihmësstomatologët**

1. Për tu regjistruar dhe anëtarësuar për herë të parë në urdhrat rajonalë, ndihmësstomatologu aplikon on line ne sistemin e USSH dhe ngarkon këto dokumenta:
  - a) Kërkesën për anëtarësim në të cilën ndihmësstomatologu shpreh vullnetin se njih Statutin e USSH, Kodin Etik dhe Deontologjik të Stomatologut dhe do të respektojë dispozitat e këtyre akteve dhe legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
  - b) Fotokopje e kartës së identitetit.
  - c) Fotokopje e noterizuar e diplomës, ose vërtetimit të barazvlefshëm me të sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”) dhe

suplementit të diplomës. Për aplikuesit që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç dokumenteve të përmendura më sipër, duhet të paraqitet edhe vërtetimi i njohjes dhe njësimit të diplomës, i lëshuar nga organi kompetent në Republikën e Shqipërisë.

- d) Raportin mjeko ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - e) Dëshminë e penalitetit dhe vërtetim nga Prokuroria.
  - f) Foto digjitale
  - g) Pagesa në favor të USSH për liçensimin për herë të parë.
2. Për shtetasit e huaj që kanë përfunduar studimet në Republikën e Shqipërisë, përveç dokumentave më sipër, paraqitet edhe kopje e noterizuar së lejes së qëndrimit dhe lejes së punës, të lëshuara nga organet kompetent në Republikën e Shqipërisë.
  3. Për liçensimin për herë të parë të ndihmësstomatologëve, shtetas të huaj që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Shqipërisë që duan të ushtrojnë profesionin si rezidentë ose jo rezidentë zbatohen të njëjtat rregulla dhe parime dhe paraqiten të njëjtat dokumente si për liçensimin e stomatologëve të huaj që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 8**

### **Dokumentacioni i nevojshëm për ri-liçensimin e ndihmësstomatologëve (Teknikë dentare, teknikë e lartë dentar, higjenist dentar, asistent dentar)**

1. Ndihmësstomatologu (Teknikë dentare, teknikë e lartë dentar, higjenist dentar, asistent dentar) paraqet kërkesën për ri-liçensim pranë urdhrave rajonale duke shoqëruar me këto dokumenta:
  - a) Kërkesën për ri-liçensim kopjen e liçensës, si dhe cv të përditësuar deri në datën kur bëhet kërkesa për riliçensim.
  - b) Raporti mjeko ligjor që vërteton aftësinë për të punuar.
  - c) Dëshminë e penalitetit dhe vërtetim nga Prokuroria.
  - d) Ekstraktin nga QKB, ose librezën e punës.
  - e) Foto digjitale
  - f) Pagesa për ri-liçensim.
2. Sekretaritetë rajonale i shtojnë këto dokumenta në dosjen e hapur për liçensimin për herë të parë nga aplikuesi. Në çdo rast sekretaritetë marrin masat që aplikuesi të mos sjellë dokumenta, të cilat janë paraqitur më parë.
3. Subjektet që kanë fituar liçensën në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi në kohën e liçensimit, por që për arsye të ndryshme kanë ushtruar profesionin e ndihmësstomatologut jashtë Republikës së Shqipërisë në zbatim të legjislacionit të një vendi tjetër dhe duan të ri-liçensohen duhet të bëjnë kërkesë në USSH rajonale duke paraqitur të njëjtat dokumenta që duhet të paraqesin stomatologët.
4. Ndihmësstomatologët, shtetas të huaj që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Shqipërisë që duan të ri-liçensohen duhet të paraqesin kërkesë në USSH rajonale duke paraqitur të njëjtat dokumenta që duhet të paraqesin stomatologët shtetas të huaj.

## Neni 8/1

### Dokumentacioni i nevojshëm për liçensimin e drejtuesit teknik

1. Çdo njësi e shërbimit stomatologjik duhet të ketë drejtues teknik.
2. Çdo njësi e shërbimit stomatologjik që ka të punësuar disa stomatologë duhet të ketë një drejtues teknik për çdo katër stomatologë. Për njësitë e shërbimit stomatologjik që kanë më shumë se katër stomatologë duhet të ketë drejtues teknik suplementar për çdo katër stomatologë.
3. Drejtuesi teknik/drejtues teknik suplementar mund të jetë vetëm stomatologu që është anëtar i USSH mbi dhjetë vjet pa ndërprerje.
4. Me kërkesë të subjektit të interesuar, drejtuesi teknik liçensohet dhe ri-liçensohet nga USSH rajonale çdo pesë vjet sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.
5. Për hapjen e njërive të reja të shërbimit stomatologjik, kërkuesi për këtë njësi duhet të paraqesi në USSH adresën ku do të ushtrohet aktiviteti. Në rast të ruajtjes së kriterëve të distancës dhe intensitetit/dendësi të zonës të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i USSH dhe të dhënave të marra nga njësitë vendore, në kuadër të ruajtjes së marrëdhënieve midis stomatologëve dhe klinikave dentare ekzistuese do të vijohet me liçensimin e drejtuesit teknik të kësaj njësie, të përcaktuar në **aneks rregullore**.
6. Stomatologu aplikon për liçensën e drejtuesit teknik online në USSH rajonale dhe ngarkon dokumentat e mëposhtëm:
  - a) Kërkesën për tu pajisur me liçensë për drejtues teknik/drejtues teknik suplementar.
  - b) Kontratat e punës për stomatologët që punojnë ose do të punojnë në njësinë e shërbimit stomatologjik.
  - c) Kopje të ekstraktit të QKB.
  - d) Pagesa për liçensën e drejtuesit teknik.
  - e) Planimentrinë e objektit ku do të ushtrohet veprimtaria, foto të jashtme dhe të brendshme të ambjentit, ose në rast se ambjenti është me qera, kontratën e qerasë.
7. Si përjashtim për njësitë e shërbimit stomatologjik që ndodhen jashtë vijës së verdhë drejtuesi teknik duhet të jetë anëtar i USSH mbi pesë vjet.
8. Në çdo rast për hapjen e një klinike dentare është e nevojshme të nxirret liçensa e drejtuesit teknik.
9. Stomatologu mund të aplikojë vetëm për një liçensë të drejtuesit teknik. Liçensa e drejtuesit teknik është e vlefshme për tu përdorur vetëm në njësinë e shërbimit për të cilën është lëshuar. Liçensa e drejtuesit teknik suplementar është e vlefshme vetëm nëse është atashuar me liçensën e drejtuesit teknik kryesor. Në çdo rast me liçensën e drejtuesit teknik suplementar nuk mund të hapet klinikë/njësi stomatologjike.

## Neni 8/2

### Drejtuesi teknik i laboratorit dentar

1. Çdo laborator dentar duhet të ketë një drejtues teknik.
2. Drejtues teknik i laboratorit dentar duhet të jetë laboranti dentar që ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune.

3. Për tu pajisur me licënsë të drejtuesit teknik, laboranti dentar duhet të paraqesi:
  - a) Kërkesën për tu pajisur me licënsë për drejtues teknik.
  - b) Kopje të ekstraktit të QKB.
  - c) Pagesa për licënsën e drejtuesit teknik.
  - d) Adresa e ushtrimit të aktivitetit e shoqëruar me foto e ambjentit ku do të ushtrohet aktiviteti.

## **Neni 9**

### **Procedura për licënsimin**

1. Asnjë stomatolog dhe ndihmësstomatolog nuk mund të ushtrojë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin e kujdesit shëndetësor publik, apo privat pa u pajisur më parë me licënsën e stomatologut apo ndihmësstomatologut, të lëshuar nga Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë dhe pa qenë anëtar i USSH. Stomatologu mban përgjegjësi për autenticitetin e dokumenteve të paraqitura dhe vërtetësinë e tyre.
2. Strukturat kompetente në USSH për licënsimin për herë të parë dhe për riliçensimet në rastet e parashikuara në këtë rregullore janë Presidenti i Urdhrit Rajonal dhe Sekretari i Urdhrit Rajonal.
3. Verifikimi paraprak i dokumentacionit për licënsim për herë të parë bëhet nga Sekretari i Urdhrit Rajonal. Sekretari i Urdhrit Rajonal pasi konstaton se dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me këtë rregullore përcjell dosjen përkatëse Sektorit të Licënsimit të USSH, i cili pasi bën verifikimin e dosjes merr masat për plotësimin licënsës dhe printimin e saj.
4. Përgjegjësi i Sektorit të Licënsimit, pasi verifikon edhe një herë dosjen e aplikantit dhe licënsën e plotësuar, e dërgon këtë të fundit për tu firmosur dhe vulosur te Presidenti i USSH dhe presidentët e urdhrave rajonalë. Pasi është firmosur licënsa, Sektori i Licënsimit bën plotësimin e regjistrit themeltar të USSH me të gjitha të dhënat e parashikuara në këtë rregullore. Pasi është plotësuar regjistri, bëhet një kopje e licënsës, e cila vendoset në dosjen personale të stomatologut, ndërsa licënsa origjinale i dorëzohet stomatologut, i cili firmos për tërheqjen e licënsës në një regjistër të veçantë të krijuar për këtë qëllim. Në mungesë të stomatologut, licënsa i dorëzohet përfaqësuesit të tij me prokurë, i cili firmos në regjistër për tërheqjen. Procedura e sipërcituar përfundon jo më vonë se dy javë. Afati mund të zgjatet vetëm për shkaqe objektive, në rastet kur ndaj stomatologut ka filluar një procedim disiplinor, ose në rastet kur licënsimi ose riliçensimi duhet të diskutohet në strukturat kompetente, e cila caktohet me vendim të Presidentit të Këshillit Rajonal.
5. Në rastet kur ka pengesa ligjore për licënsimin për herë të parë, urdhri rajonal harton vendimin e arsyetuar, të cilin ja njofton stomatologut në mënyrën e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Stomatologu ka të drejtën e ankimit pranë Presidentit të USSH brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Stomatologu ka të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të urdhrit rajonal dhe vendimit të Presidentit të USSH.

6. Si rregull, licenca lëshohet vetëm një herë. Në rastet kur stomatologu humbet licensën, apo licenca dëmtohet për shkaqe objektive të pavarura nga vullneti i stomatologut, USSH lëshon dublikat të licensës kundrejt pagesës së përcaktuar për lëshimin e licensës.
7. Në çdo rast urdhri rajonal dhe Sektori i Licënsimit janë përgjegjës për plotësimin e dosjes dhe saktësinë e të dhënave në licensë dhe në regjistrin themeltar të USSH.
8. USSH ndjek të njëjtën procedurë për licënsimin dhe rilicënsimin e ndihmësstomatologëve (Teknikë dentare, teknikë e lartë dentar, higjenist dentar, asistent dentar).

## **Neni 10**

### **Procedura për ri-licënsimin e stomatologëve**

1. Aplikimi për rilicënsim bëhet jo më vonë se dy javë përpara se të përfundojë afati i licensës.
2. Sekretari i Këshillit Rajonal të Urdhrit të Stomatologut bën verifikimin e dokumenteve të paraqitura për ri -licënsimin. Në rastet kur dokumentacioni është i plotë, sekretari i Këshillit Rajonal dërgon për miratim pranë Sektorit të Licënsimit të USSH aplikimin për ri-licënsim. Përgjegjësi i Sektorit të Licënsimit, pasi verifikon edhe një herë dosjen e aplikantit dhe licensën e plotësuar, e dërgon këtë të fundit për tu firmosur dhe vulosur te Presidenti i USSH dhe presidentët e urdhrave rajonalë dhe dërgon licensën te urdhrat rajonalë. Sekretari i Këshillit Rajonal bën plotësimin e regjistrit përkatës të krijuar për këtë qëllim me të gjitha të dhënat e parashikuara në këtë rregullore. Pasi është plotësuar regjistri, bëhet një kopje e licensës, e cila vendoset në dosjen personale të stomatologut, ndërsa licensa origjinale i dorëzohet stomatologut, i cili firmos për tërheqjen e saj në një regjistër të veçantë të krijuar për këtë qëllim. Në mungesë të stomatologut, licensa i dorëzohet përfaqësuesit të tij me prokurë, i cili firmos në regjistër për tërheqjen. Procedura e sipërcituar përfundon jo më vonë se dy javë. Afati mund të zgjatet vetëm për shkaqe objektive, në rastet kur ndaj stomatologut ka filluar një procedim disiplinor, ose në rastet kur për ri-licënsimin duhet të shprehet Presidenti i USSH, ose Këshilli Kombëtar.
3. Në rastet kur ka pengesa ligjore për ri-licënsimin, hartohet vendimi i arsyetuar, i cili i njoftohet stomatologut në mënyrën e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Stomatologu ka të drejtën e ankimit pranë Presidentit të USSH brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Stomatologu ka të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të Urdhrit Rajonal dhe vendimit të Presidentit të USSH.
5. Kur aplikimi bëhet jashtë afateve të vlefshmërisë së licensës, aplikohet 100 lekë penalitet për çdo ditë vonesë përveç pagesës së kuotave, si dhe varësi të afatit të vonesës zbatohen aktet e tjera për procedimet disiplinore. Për vonesat mbi një vit aplikohet 200 lekë penalitet dhe fillon automatikisht procedimi disiplinor.

6. Për raste të veçanta, kur ka shkaqe të justifikuara për stomatologë me kontribute në fushën e stomatologjisë, ose kontribute ndërkombëtare, Presidenti i USSH mund të vendosë për përjashtimin e stomatologut nga penalitetet.

### **Neni 11**

#### **Rifitimi i të drejtës për të ushtruar profesionin**

1. Stomatologu dhe ndihmësstomatologu që për çfarëdo arsye nuk ka ushtruar profesionin për një periudhë mbi pesë vjet, për të rifituar të drejtën për të ushtruar profesionin duhet:
  - a) Të kryejnë procedurat e riliçensimit në USSH në përputhje me dispozitat e statutit të USSH dhe kësaj rregulloreje.
  - b) Ti nënshtrohet praktikës profesionale të mbikqyrur për një periudhë tre mujore, në përfundim të së cilës pajiset me dokumentin zyrtar i cili konfirmon aftësinë për të ushtruar profesionin si stomatolog i pavarur.
  - c) Të paguajë kuotat e anëtarësimit, penalitetet dhe tarifatat për pajisjen me licensë.
  - d) Të pajiset me licensën për ushtrimin individual të profesionit.
2. Përjashtohet nga detyrimi për të kryer praktikën profesionale, stomatologu që nuk ka ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë, por e ka ushtruar profesionin në një shtet tjetër. Në këtë rast stomatologu paraqet dokumentacion përkatës për riliçensimin e tij sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, si dhe bën pagesat përkatëse sipas pikës 1, shkronja “c” të këtij neni.

### **Neni 12**

#### **Pezullimi i licensës të ushtrimit të profesionit**

1. Stomatologut dhe ndihmësstomatologut anëtar të USSH i pezullohet licensa në këto raste:
  - a) Kur me vendim të formës së prerë së gjykatës është hequr e drejta për ushtrimin e një funksioni publik për një periudhë të caktuar për vepra penale që lidhen me profesionin e stomatologut.
  - b) Nuk shlyen kuotat e anëtarësimit brenda afateve të përcaktuara pas lajmërimit të USSH ose urdhrave rajonalë.
  - c) Nuk plotëson kreditet e nevojshme për ushtrimin e profesionit të stomatologut, ose ndihmës stomatologut sipas legjislacionit në fuqi.
  - d) Nuk kalon provimin e programit të certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë sipas legjislacionit në fuqi.
  - e) Kur nuk shlyen masën disiplinore plotësuese të dhënë me vendim të formës së prerë të komisioneve disiplinore në zbatim të pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr. 127/2014 “*Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë*”.
  - f) Me kërkesë të stomatologut.
  - g) Në raste të tjera kur shihet e arsyeshme nga Presidenti i USSH.
2. Vendimi për pezullimin e licensës merret nga Presidenti i USSH. Vendimi i njoftohet stomatologut sipas përcaktimeve ligjore, i cili ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

3. Nëse pezullohet liçensa e ushtrimit të profesionit, automatikisht pezullohet dhe liçensa e drejtuesit teknik.
4. Shkaqet e pezullimit nuk pengojnë komisionet disiplinore për të marrë masat përkatëse nëse konstatohen shkelje të Kodit Etik dhe Deontologjik.

### **Neni 13** **Heqja dhe anulimi i liçensës**

1. Liçensa mund të hiqet me një afat të caktuar, ose në mënyrë përfundimtare. Liçensa hiqet në mënyrë përfundimtare vetëm me vendim të formës së prerë të gjykatës.
2. Liçensa hiqet për një afat të caktuar me vendim të formës së prerë të komisioneve disiplinore për një periudhë deri në tre vjet në zbatim të pikës 1, shkronja “dh” të nenit 15 të ligjit nr. 127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.
3. Nëse hiqet liçensa e ushtrimit të profesionit, automatikisht hiqet dhe liçensa e drejtuesit teknik.
4. Anulimi i liçensës bëhet në rastet kur ajo është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.
5. Vendimi i njoftohet stomatologut sipas përcaktimeve ligjore, i cili ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

### **Neni 14**

#### **Certifikata e sjelljes së mirë (*Goodstanding certificate*)**

1. Me kërkesë të stomatologut, USSH lëshon kundrejt pagesës së përcaktuar Certifikatën e sjelljes së mirë (*Goodstanding certificate*), të plotësuar në gjuhën shqipe, e cila firmoset nga Presidenti i USSH për periudhën që stomatologu ka qenë i liçensuar dhe ka ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë.
2. Pasi bën verifikimet përkatëse në dosjen personale të stomatologut, si dhe ka marrë informacion nga komisionet disiplinore rajonale dhe Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar, Sektori i Liçensimit plotëson certifikatën në gjuhën shqipe dhe i paraqet për firmë Presidentit të USSH. Procedura përfundon jo më vonë se dy javë pune nga dita që është paraqitur kërkesa.
3. USSH mund të lëshojë edhe vërtetime të tjera brenda dhjetë ditëve në varësi të kërkesave të stomatologëve, të cilat lëshohen nga Presidenti i USSH pasi janë bërë verifikimet përkatëse nga Sektori i Liçensimit.

## **KREU III**

### **ADMINISTRIMI I DOSJEVE PERSONALE DHE REGJISTRAVE TË USSH**

#### **Neni 15**

#### **Administrimi dhe përditësimi i dosjeve personale të stomatologëve, regjistrave pranë Këshillit Rajonal dhe Regjistrat Themeltar të USSH**

1. Dosja personale e stomatologut përmban të gjithë dokumentacionin e parashikuar në këtë rregullore duke filluar nga aplikimi për të zhvilluar praktikën profesionale, deri në liçensimin e fundit të stomatologut. Dosjes i vihet numri që ka në USSH, ose numri që ka pasur në UMSH (kur dosja është kaluar nga UMSH). Dosjet e stomatologëve që kanë vdekur, apo me kërkesë të tyre janë çrregjistruar nga USSH ruhen në një ndarje të veçantë.
2. Regjistri rajonal mbahet nga Sekretaria e Këshillit Rajonal në formë të shkruar dhe elektronike. Regjistri Rajonal përditësohet nga Sekretaria e Këshillit Rajonal menjëherë, pasi është firmosur liçensa e stomatologut. Dosjet vendosen në një ambjent të posaçëm në rafte sipas rendit alfabetik ku shënohet inicjali i emrit dhe mbiemrit të stomatologut.
3. Sekretaria e Këshillit Rajonal nën mbikqyrjen e Presidentit të Këshillit Rajonal në fund të çdo muaji dërgon në USSH të dhënat (kopje të njësuara të liçensave) për riliçensimet në formë shkresore dhe elektronike për të bërë përditësimet përkatëse në Regjistrin Themeltar të USSH.
4. Kur stomatologu largohet dhe punësohet në një rajon tjetër, bën kërkesë për transferimin e dosjes të paktën pesëmbëdhjetë ditë përpara në Sekretarinë e Rajonit në të cilin është i punësuar. Dosja e tij, përfshirë informacionin për pagesën e kuotave, transferohet në rajonin ku dëshiron të transferohet. Sekretaria e Këshillit Rajonal pritës administron dosjen dhe informon menjëherë Aparatin Qëndror të USSH, i cili bën përditësimin në Regjistrin Themeltar të USSH.
5. Kur drejtuesi teknik largohet nga njësi stomatologjike për të cilën është liçensuar, njofton Urdhrin Rajonal dhe administratën qendrore të USSH për këtë largim dhe dorëzon liçensën origjinale pranë rajonit përkatës. Në rast se stomatologu dëshiron të liçensohet si drejtues teknik në një klinikë tjetër, bën aplikimin përkatës duke bërë pagesën për liçensën e re.
6. Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë krijon dhe administron regjistrin themeltar të urdhrin, i cili është i ndarë në pjesë të veçanta për stomatologët dhe ndihmësstomatologët dhe menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij. Regjistri mbahet në formë të shkruar dhe elektronike. Sektori i liçensimit në USSH është struktura përgjegjëse për administrimin e regjistrin dhe përditësimit të tij, duke respektuar legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. Të gjithë stomatologët, anëtarë të Urdhrit të Stomatologut kanë numrin e tyre në regjistrin themeltar të USSH. Regjistri në formë elektronike publikohet në faqen zyrtare të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë duke bërë publike vetëm të ato të dhëna që nuk përbëjnë të dhëna personale.
8. Sektori i liçensimit në USSH monitoron përditësimin e regjistrin rajonal nga Sekretaritë e Rajoneve. Ai raporton të dhënat statistikore, ose çdo të dhënë tjetër përpara Presidentit të USSH dhe Këshillit Kombëtar si dhe për liçensimet e reja dhe ri-liçensimet kur kjo kërkohet, ose çdo katër muaj.

## **Neni 16**

### **Tarifat**

1. Tarifat për çdo shërbim, liçensat, vërtetimet, aktet administrative që lëshohen nga USSH dhe Urdhrat Rajonalë, si dhe kuotat e anëtarësisë miratohen dhe ndryshohen nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Stomatologut.

## Neni 17

### Hyrja në fuqi

1. Rregullorja dhe çdo akt tjetër që ka të bëjë me regjistrimin, liçensimin dhe anëtarësimin që kanë qenë fuqi deri në momentin e miratimit të kësaj rregulloreje, shfuqizohen.
2. Rregullorja publikohet menjëherë në faqen zyrtare të USSH.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj.

**Miratuar në mbledhjen e Këshillit Kombëtar datë 19.12.2025.**